

Formular për SYLLABUS të Lëndës KIF

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës
Titulli i lëndës:	Kontabiliteti i Institucioneve Financiare
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Semestri VI (viti III-të)
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Edona Perjuci
Detajet kontaktuese:	edona.perjuci@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kontabiliteti i institucioneve financiare, është njëra ndër lëndët obligative që iu ofrohet studentëve të vitit të tretë në departamentin Kontabilitet. Kjo lëndë është e dedikuar ti plotësoj njohuritë e studentëve me kontabilitetin e institucioneve financiare specifikisht. Puna rreth përgatitjeve të raporteve financiare dhe shfrytëzueshmëria nga ana e atyre që marrin vendime afariste do të jenë synim i kësaj lënde. Kjo lëndë ka të bëjë me shfrytëzimin e informatave nga përdoruesit që marrin vendime afariste. Qëllimi ynë është të tregojmë se si përdoren sot informatat e kontabilitetit në institucionet financiare. Institucionet financiare janë përdoruesit më intenziv të raporteve financiare mirepo në të njëjtën kohë edhe vet kontabiliteti i institucioneve financiare është me interes sidomos për studentët të cilët së shpejti do tu bashkohen këtyre institucioneve.
Qëllimet e lëndës:	Lënda është e dizajnuar për të plotësuar njohuritë e kontabilitetit të institucioneve financiare për studentët e vitit të tretë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Kur ju kompletoni lëndën Kontabiliteti I institucioneve financiare, do të duhej të: • Kuptoni rolin e kontabilitetit në marrjen e vendimeve lidhur me institucionet financiare; • Kuptoni veprimtaritë në kuadër të institucioneve financiare; • Kuptoni konceptet themelore të matjeve në institucionet financiare; • Kuptoni raportimin e fitimeve dhe situatave financiare; • Kuptoni interpretimin e raporteve financiare te institucioneve financiare.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	1	1	1
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj	1	15	15
Totali			100 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Përcjellja e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve është esenciale. Studentët të cilët janë të rregullt kanë sukses ndërsa ata të cilët nuk shkojnë rregullisht në orë kanë probleme. Leximi i rregullt i kapitujve të përcaktuar më parë. Mësimi i kësaj lënde është i vazhdueshëm, kuptimi i koncepteve të reja është ngushtë i lidhur me mësimin e koncepteve nga kapitujt paraprak. Mundohuni të zhvilloni kuptimin e koncepteve. Mos tentoni të mbani në mend materialet. Në të shumtën e rasteve mbajtja mend nuk do të ndihmoj në studimin tuaj. Në këtë lëndë detyrat në të shumtën e rasteve kërkojnë të aplikoni konceptet e mbuluara më herët dhe të mendoni për materialet e prezantuara më herët. Këto detyra nuk mund të kryhen pa i trajtuar në esencë problemet dhe pa menduar mirë. Kjo na jep të kuptojmë se nuk duhet të ngutemi në fillimin e kryerjes së detyrës në formën teknike për detyra të caktuara. Duhet të kaloni pak kohë duke konsideruar mësimet e mbuluara në klasë dhe kërkesat lidhur me detyrat specifike.		
Metodat e vlerësimit:	Testet duhet të mbahen në orarin e caktuar. Mungesat nga testet dhe caktuara pa pëlqimin paraprak të ligjëruesit do të rezultojnë me poenat prej zero. Orari i testeve gjatë semestrit është si në vijim: Testi 1 Java 9 Testi 2 Java 14 Testi 3 Java 15 Kushti I hyrjes në teste vijuese është kalimi I testeve paraprake me 50% të poenave.		

Notimi: A) Provimi do të determinohet nga këto aktivitete:	
Testi 1	20 poena
Testi 2	20 poena
Testi 3 final me goje	30 poena
Angazhimi ne ushtrime	10 poena
Angazhimi në ligjërata	20 poena
 Totali i poenave	 100 poenave
Shkallët e notave: Ne do të shfrytëzojmë këtë shkallë të notimit	
91-100%	A/10
81-90%	B/9
71-80%	C/8
61-70%	D/7
51-60%	E/6
50-me pak	F/5

Literatura

Literatura bazë:	Arben Dermaku & Arber Hoti: "Kontabiliteti I institucioneve financiare", Prishtinë, 2019.
Literatura shitesë:	Resurse te internetit përkatesisht web faqet e institucioneve financiare.

Plani i dizejnuar i mësimit:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Njohtimi me sillabusin
<i>Java e dytë:</i>	K1-Njohja me institucionet financiare K2 - Bankat komerciale si koncept
<i>Java e tretë:</i>	K3 - Njohja me pasqyrat financiare te bankave komerciale
<i>Java e katërt:</i>	K4 - Trajtimi kontabël i transaksioneve kryesore të bankave komerciale(79-95)
<i>Java e pestë:</i>	K4 - Trajtimi kontabël i transaksioneve kryesore të bankave komerciale(95-137)
<i>Java e gjashtë:</i>	K5 - Analiza financiare e bankave komerciale
<i>Java e shtatë:</i>	K5 - Analiza financiare e bankave komerciale
<i>Java e tetë:</i>	TESTI 1 (PER PJESEN E BANKAVE)
<i>Java e nëntë:</i>	K6 Sigurimi si koncept &
<i>Java e dhjetë:</i>	K7 Roli i kompanive te sigurimit ne zhvillimin ekonomik&
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	K8 - Njohja me pasqyrat financiare te kompanive te sigurimit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	K9 - Trajtimi kontabël i transaksioneve kryesore të kompanive të sigurimit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	K10 - Analiza financiare e kompanive të sigurimit
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	TESTI II (PER PJESEN E KOMPANIVE TE SIGURIMIT)
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi III- me goje

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obliguar për të gjithë studentët e rregullt. Të gjithë studentët janë të obliguar që t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë, ç'kyqja e telefonave celularë dhe hyrja në sallë me kohë.